

VENDIM
Nr. 16, datë 20.1.2021

**MBI ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 687, datë 22.11.2017 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi’”, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 9/11 prot., datë 16.1.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021,

KONSTATOI SE:

- Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 270, datë 28.12.2020, la në fuqi vendimin nr. 94, datë 8.6.2020, “Mbi çmimin e aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2020, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020”, deri në miratimin e një çmimi nga ERE, mbështetur në publikimin e raportit vjetor të Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX), si dhe publikimet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit lekë/EUR.

- Meqenëse raporti vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të Bursës Hungareze të Energjisë, si dhe publikimet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit lekë/EUR janë të publikuara në faqet e tyre zyrtare, në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 270, datë 28.12.2020, paraqiten llogaritjet për çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021.

- Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) është marrë çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2020 i cili rezulton në vlerën 39.00 euro/MWh.

- Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit lekë/EUR, për çdo muaj të vitit 2020 rezulton se kursi mesatar i këmbimit për vitin 2020 të jetë 123.77 euro/lekë.

- Nisur nga elementët e përcaktuar më sipër dhe në zbatim të formulës për llogaritëse të pikës 3, të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, në lidhje me metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, llogaritjet reflektohen si më poshtë:

- $P_u = 39.00 / 1000 * 1.2 * 123.77 = 5.7924$ lekë/kWh.

- Ndërkohë, në germat “ç” dhe “d”, të pikës 2, të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, përcaktohen kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, të cilët janë përkatësisht: jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016.

Meqenëse nga llogaritjet e kryera, çmimi i llogaritur sipas formulës së cituar në metodologji rezulton me i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016, sipas parashikimeve të germës “ç”, të pikës 2, të VKM-së së sipërpërmendur, çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021 rezulton ai prej 7.448 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021 të jetë 7.448 lekë/kWh.

2. Me publikimin e raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020, në rast se kursi i këmbimit lekë/EUR do të rezultojë i ndryshëm nga vlera e publikuar deri në marrjen e këtij vendimi, ERE do të korrigjojë çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, i cili do t’u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2021.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti